



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Komunitete

Nr. 02-060/01-0009466-1/26 dt. 27.02.2026

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja konstituive e Komitetit për Komunitete
Seanca e 1-rë

Koha: 27.02.2026 ora 11:00

Vendi: Salla e Mediave

Të pranishëm: Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi

Anëtarët e Komitetit për Komunitete: Fisnik Suma, Armend Begu, Xhyljeta Imeri, Flamur Vojvoda, Gjergj Beka, Jeton Ujkani, Fitim Terziqi, Dzenita Sabani, Sibela Fetahu, Hamide Hyseni dhe Sadete Gashiani

Mungoi:

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi i cili fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe theksoi se në zbatim të nenit 51, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 61, paragrafi 2, dhe nenit 62, të Statutit të Komunës; nenit 12, paragrafi 1, të Rregullores për punën e Kuvendit; nenit 14, paragrafi 3, të Rregullores për punën e komiteteve të Kuvendit; për sot kam thirrur mbledhjen konstituive të Komitetit për Komunitete me këtë:

REND DITE:

1. Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete

Kryesuesi i Kuvendit Safet Kamberi konstatoi se unanimisht u miratua rendi i ditës.

Pika 1

Kryesuesi e mbledhjes pasi theksoi se zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete është në kompetencë të këtij komiteti dhe i njëjti zgjidhet nga anëtarët e këtij komiteti kërkoi nga anëtarët e Komitetit që të fillojnë me propozimet.

Xhyljeta Imeri: Është mirë që Kryesuesi i Komitetit për Komunitete të zgjidhet nga radhët e komuniteteve, sepse janë ata që më së miri i njohin dhe i dinë problemet dhe vështirësitë me të cilat përballen.

Sibela Fetahu: Kërkoj 5 minuta pauzë në mënyrë që ne përfaqësuesit e komuniteteve të dakordohemi për zgjedhjen e Kryesuesit të këtij Komiteti.

Kërkesa e znj. Sibela Fetahu u miratua nga anëtarët e Komitetit për Komunitete.

Në vazhdim, znj. Sibela Fetahu propozoi që Kryesuese e Komitetit për Komunitete të jetë znj. Hamide Hyseni.

Anëtarët e Komitetit për Komunitete me shumicë votash (10 për, 0 kundër dhe 0 abstenime) votuan që Kryesuese e Komitetit për Komunitete të jetë znj. Hamide Hyseni.

Mbledhja përfundoj punimet në ora 11:20 min.

Mitrovicë
27.02.2026

Procesmbajtës:


Afërdita MAXHUNI

Kryesuesi i Kuvendit


Safet KAMBERI

